

## ASIME FERAJ

### NEOLOGJIZMAT NË VEPRËN E FATOS ARAPIT

Gjuha e letërsisë artistike përbën stilin a variantin më të gjerë e të larmishëm të gjuhës sonë letrare kombëtare. Ajo ka gjithashtu mundësitë më të mëdha për të qëndruar fort në truallin e gjuhës popullore e për t'u ushqyer prej saj dhe njëkohësisht për t'u lidhur ngushtë me traditën e gjuhës letrare, sepse në asnjë fushë gjallëria e forca e gjuhës nuk është aq e fuqishme e jetëgjatë sa në letërsinë artistike.

Për shkrimtarin fjala është lënda e parë për të shkruar një vepër letrare. Kjo e vërtetë shprehet edhe në përkufizimin e letërsisë si “arti i fjalës”. Pa fjalë, pa gjuhë, nuk mund të ketë letërsi. Kjo lidhje e ngushtë e letërsisë me gjuhën shfaqet në të gjitha rrafshet, si në rrafshin e krijimit letrar, ashtu edhe në rrafshin teorik, d.m.th. të disiplinave që merren me këto dy dukuri. E parë me këtë sy shkrimtari duhet të forcojë më tepër kujdesin dhe përgjegjësinë për gjuhën letrare kombëtare. Kjo do të thotë se:

1. Letërsia artistike duhet të depërtojë edhe në shtresat më të thella të thesarit të popullit dhe ta përpunojë thellë siç përpunon idetë poetike, sepse gjuha për letërsinë artistike shkrihet me përmbajtjen ashtu siç shkrihet mermeri në një shtatore.

2. Është koha që letërsia të japë një ndihmesë të madhe për pasurimin dhe pastrimin e shqipes nga fjalët dhe nga ndërtimet e huaja të panevojshme<sup>1</sup>.

Gjuha në letërsinë artistike përdoret si mjet për të realizuar në radhë të parë funksionin estetik dhe bën pjesë në tërësinë e vet në Gj. L. K. por jo vetëm kaq. Gjuha në letërsinë artistike përfaqëson shkallën më të lartë të përparimit të gjuhës së çdo populli, sepse letërsia artistike është arti i fjalës dhe ka një forcë të madhe vepruese tek lexuesit. Gjuha e letërsisë artistike zë vend thellë në zemrat dhe në mendjet e tyre, i pasuron dhe i fisnikëron shpirtërisht, por mbi të gjitha u shton dashurinë për gjuhën amtare.

---

<sup>1</sup> A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*. “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f. 31.

Është vështirë të gesh në Evropë një gjuhë tjetër letrare që të ketë bërë brenda një shekulli një hap cilësor kaq të gjerë e të shpejtë sa ai i shqipes. Këtë hap ajo e ka bërë në të gjitha fushat, por ndihmë më të madhe në këtë ka dhënë edhe letërsia artistike. Shkrimtarët nëpërmjet artit të fjalës e kanë ngritur shqipen letrare kombëtare në shkallën e gjuhëve më të përparuara të letërsisë botërore, i kanë zgjeruar shumë kufijtë e saj nëpërmjet mishërimit të ideve të mëdha duke rritur forcën e saj shprehëse.

Në këtë vepër me rëndësi kanë marrë pjesë disa breza, artistë të shquar të fjalës. Shumë prej tyre janë kthyer modele për vlerat gjuhësore si: N. Frashëri, Çajupi, Gj. Fishta, F. Noli, D. Agolli, I. Kadare, F. Arapi etj.

Një nga rrugët për pasurimin e gjuhës është edhe rigjallërimi i fjalorit të letërsisë së vjetër. Shumë fjalë të autorëve të vjetër kanë humbur dhe sot nuk përdoren më. Mjaft prej tyre mund të përdoren në stile të caktuara të gjuhës letrare, sidomos në letërsinë artistike, për të dhënë një kuptim të ri ose një nuancë kuptimore të re ato mund të rigjallërohen, p.sh.: *frutoj* “nxjer fruta”, *i frutueshëm*, *i pafrut* **Budi**; *i pafrutuar*, *frutues dhe frutesë* (të dhënit frut) **Bardhi**; *arrëtoj* “shpik, trilloj” *arrëti*, *arrëtim*, *arrëtues*; *shtatpëlqyer* “xhuxhmaxhuxh”, *tridhambësh* “sfurk”, *mjalcë* “bletë”, **Bardhi**; *zemërkëmyem* “frikacak”, *therëcë* “ferrë”, bamir **Buzuku**; *kryekërçym* “inati”, *i papasur* “i varfër”, *i pafaqe*, *dritëzë* “kandil”, *binosh* “binjakë”, *ndërkamb* “marr nëpër këmbë”, *akulloj* “ngrij”, *akullohem* “më ngrin zemra” **Bogdani**<sup>2</sup>.

Me prapashtesën *-tar*: *peshkatar*, *gojëtar* “avokat” **Buzuku**; *fjalëtar* “që flet bukur”, *pajëtar* “ndihmës” **Kuvendi i Arbrit**; *kundërtar* **Bardhi**; *arrëtues* “trillues”, *manesë* “vonesë”, *trajtoj* “ndërtoj” **Kristoforidhi**;

Me prapashtesën *- (e)zë*: *hiezë* “çadër”, *bamezë* “vepër”, *krefezë* “kurth” **Bardhi**

Mbiemra me kuptim mohor, me paranyjëzim, me parashtesën *-pa*: *i paurtë* “i parregullt” **Buzuku**; *i padëllirë* **Budi**; *i padashur* “mosmirënjohës” **Bogdani**.

Disa nga fjalët e autorëve të vjetër Kristoforidhi u mundua t'i ngjallte në shkrimet e tij, disa prej këtyre fjalëve u përdorën në të gjithë letërsinë e Rilindjes. Disa fjalë që përdorim sot si: *dëftues*, *grykës*,

<sup>2</sup> A. Sinani – S. Bulo, *Visari i fjalëve dhe i shprehjeve popullore – burim i madh për pasurimin e g.j.l.k.* në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989, f. 421.

*këngëtar, detar, këshilltar, madhështi, trajtim, shkollor, kondërshtar* i gjejmë qysh tek autorët e vjetër<sup>3</sup>.

Shkrimet shqipe, që nga më të hershmet, na dëshmojnë se në gjuhën tonë janë krijuar e kanë hyrë në përdorim shumë fjalë të reja, që e kanë zgjeruar mjaft leksikun e saj. Edhe në ditët tona leksiku i shqipes është pasuruar me shumë fjalë e shprehje. Këtë e dëshmon edhe ky punim, i cili trajton formimin e fjalëve të reja të krijuara nga Fatos Arapi, duke u bërë kështu vazhdues i traditës më të hershme dhe më të bukur, atë të përpjekjes për pasurimin e leksikut të shqipes.

Në këtë punim jam ndalur në fjalë që fitojnë përdorim të veçantë në veprën e Fatos Arapit pasi autori shquhet për njohje të thellë të pasurisë leksikore e semantike të shqipes e të krahinës së Labërisë në veçanti duke e përdorur atë me finesë, sepse ka të qartë se fjalët dialektore janë mundësi për t'u thithur nga gjuha standarde. Gjithashtu autori e pasuron gjuhën shqipe me njësi të reja leksikore me brumin e vetë shqipes. Kjo është edhe merita më e madhe e autorit.

Fjalët e trajtuara si neologjizma në këtë punim, janë vjelë nga krijimtaria e autorit vetëm nga poezia dhe proza, pa u ndalur te drama, përkthimet dhe studimet e ndryshme. Për vërtetësinë e tyre jemi këshilluar me "*Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*", 1980.

Po pse me këtë fjalor, kur ne kemi një numër të konsiderueshëm të fjalorëve shqip?

"*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*", 1980 është vlerësuar si një nga arritjet më të mëdha të shkencës gjuhësore shqiptare<sup>4</sup>. Është fjalori më i

---

<sup>3</sup> I. Arapi, *Gjallërimi i disa njësive leksikore të autorëve të vjetër për pasurimin e gjuhës së sotme letrare*. "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989, f. 431.

<sup>4</sup> Shiko më gjerë: J. Kole, *Prirje të zhvillimit të leksikut në dritën e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*. në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989; P. Haxhillazi, *Rreth karakteristikave stilistike të fjalëve në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*. në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989; Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*, në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989; H. Shehu, *Mbi pasqyrimin e leksikut popullor me vlerë potenciale në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*. në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989; A. Hidi, *Rreth veçorive leksiko-gramatikore të fjalëve në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*. në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", III, Tiranë, 1989; A. Buda, "*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*", një vepër madhore e shkencës shqiptare, në "Studime mbi

madh i botuar deri më sot, me mbi 41.000 fjalë, dhe mbi 8.000 njësi frazeologjike<sup>5</sup> dhe me mbi 180.000 kuptime.<sup>6</sup> Është *fjalor shpjegues normativ dhe njëkohësisht një fjalor informues*.

Është fjalori në të cilin jepet zbërthimi dhe përcaktimi i kuptimeve të fjalëve e i ngjyimeve (nuancave) të tyre, të cilat tregojnë përdorimin e tyre të drejtë në ligjëratë.

Në korpusin leksikor të veprës së Arapit hasen formime tipike (që janë formuar nga autori) **parashtesore**, **prapashtesore** e sidomos me **përbërje** ku autori shfaq mjeshtëri dhe individualitet të lartë si në krijimet e hershme ashtu edhe në krijimet më të vona ku ngarkesa kuptimore është tepër e lartë.

#### **Fjalë të formuara me ndajshtesa**

Formimi i fjalëve të reja me ndajshtesa (parashtesave dhe prapashtesave) është rruga më prodhimtare në gjuhën shqipe. Fjalët e formuara me parashtesim në gjuhën shqipe janë më të pakta, sesa ato me prapashtesim, sepse gjuha jonë ka më pak parashtesa se prapashtesa (68/170)<sup>7</sup>. Edhe në krijimtarinë e Fatos Arapit bie në sy e njëjta gjë, numri më i madh i fjalëve të reja janë me prapashtesim.

#### **Formime me parashtesim**

Tek parashtesimi do të veçonim formimet me vlera shënuese e stilistikore me parashtesat: **-pa e -për**

Parashtesa *-pa* përdoret për të formuar emra dhe mbiemra dhe kuptim të kundërt nga ai i fjalës: *sytë e padritë*, *ëndërr e paëndërruar*, *të paqena*, *i pazbutshëm*, *i paformët ...* etj.

Parashtesa *-pa* u shtohet jo vetëm pjesoreve të mbiemërzuar për të formuar antonimet e tyre si: *e paëndërruar*, *të paqena*, por edhe temave emërore dhe përsëri rezultati është mbiemër: *sytë e padritë*. Përdoret për të

---

leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989; M. Domi, *Ngjarje e shënuar në jetën kulturore dhe shkencore*. në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989; Lafe, E., “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, një vepër e re gjuhësisë sonë, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III, Tiranë, 1989 etj.

<sup>5</sup> L. Nallbani, Hyrje në *Frazeologjia në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*. Piramida, Prishtinë, 2009.

<sup>6</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Ribotim, Tiranë, 2005, f. 334.

<sup>7</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2005, f. 147-149.

formuar emra dhe mbiemra dhe kuptim të kundërt nga ai i fjalës:  
*pazbutshëm, i paformët,*

**-pa:** *i pazbutshëm, i paformët* “Nuk shitet shpirti ...”; *e padritë* “Dikush më buzëqeshte”; *i padrojtshëm* “Nuk shitet shpirti ...”; *parëndë* “Shokët” të *paemërtit* “Poezi”; *i paëndërruar* “Ritme të hekurta”;

**-për:** *përçik, përdëlluese* “Eklipsi i ëndrës” *përdëlluese, përshfaq* “Intenebris”; *përskuqur* “Dikush më buzëqeshte”; *përfal* “Nuk shitet shpirti ...”; *përzheritëse, “Patat e egra”;*

**-mos:** *moskohë* “Gloria viktor”;

**-nën:** *nëndheu* “Ku shkoni ju statuja”

**-sh:** *shlirshëm, shkujdesshëm* “Nuk shitet shpirti në tetor”;

**-stër:** *stërkalbur, stërmoçme, stërpërdorur* “Eklipsi i ëndrës”; *stërhapur* “Dikush më buzëqeshte”;

#### Formime me prapashtesim

**-ar, -or, -ore:** *koskore, vjeshtor* “Shokët”; *mjegullor, muzgor, synor* “Dikush më buzëqeshte”; *rrafshirë, qyqar* “Dikush më buzëqeshte”; *shpellar* “Nuk shitet shpirti në tetor”;

**-ak:** *pushatak* “Nuk shitet shpirti në tetor”;

**-shëm:** *drojtshëm* “Nuk shitet shpirti ...” *kërcëllueshëm, ndritshëm* “Ku shkoni ju statuja”; *detshtëm, ngjethshëm* “Deti në mes”; *drojtshëm, inatshëm, hidhshëm, qetshëm,* “Nuk shitet shpirti ...”;

**-inë:** *boshtinë* “Nuk shitet shpirti ...”;

**-të, -irtë:** *dlirtë* “Nuk shitet shpirti ...”; *i ullirtë, gjaktë* “Dikush më buzëqeshte”;

**-tar, -tor:** *qethore* “Nuk shitet shpirti në tetor”;

**-al, -ol:** *thërrmol* “Eklipsi i ëndrës”;

**-isht:** *skandalisht* “Eklipsi i ëndrës”; *dinakërisht* “Ku shkoni ju statuja”; *blatishhtë* “Shokët” *bokërrishte* “Dikush më buzëqeshte”; *skandalisht* “Eklipsi i ëndrës”;

**-om, -im:** *plagoma Vellezer H...* : *rektimë* “Ku shkoni ju statuja”; *firomë* “Dikush më buzëqeshte”;

**-an, -on:** *sqepon* “Eklipsi i ...” *prushanë* “Ku shkoni ju ...”; *muranë* “Patat e egra”

**-o/j:** *hepoj* “Nuk shitet shpirti në tetor”;

**-iqe:** *gardhiqeve* “Deti në mes”;

**-os:** *kanos, kurrizin e shqipos* “Deti në mes” *xhindos* “Patat e egra”; *krahos* “Dikush më buzëqeshte” *sterros* “Shokët”;

**-ës/ -ues:** *xixues* “Eklipsi i ëndrës”; *shkreptues* “Ritme të hekurta”;

**-je:** *rigasje* “Nuk shitet shpirti ...”;  
**-çe:** *evropiançe* “Nuk shitet shpirti ...”;  
**Me nyjëzim:** *e dritësuar* “Eklipsi i ëndrrës”

Shumë nga këto fjalë duket sikur janë krijime të Fatos Arapit. Është detyra jonë në të ardhmen të vemi në kartotekën e shqipes për të bërë verifikimet nëse ato janë fjalë të krijuara rishtazi apo fjalë të shqipes.

Te Fatos Arapi gjejmë edhe neologjizma stilistikë të krijuara me anë të prapashtesave që shprehin vlerësime emocionale. Nga këto prapashtesa shumë e përdorshme është prapashtesa zvogëluese, përkëdhelëse, -zë, si: *rrëmbezë* “i vë gjoksin rrëmbezës”, vijë e vogël uji; *çupëz* “çupëz moj fluturëz prej bore”, *arkëz* “Ja dhe gjyshja në arkëz”, *kartëz* “Kukull e vogël në kartëz”, *lakëzat* “arrinin gjer te lakëzat e pulpave” etj, si: *këmishëz*, *lëndinëz*, *derëz*, *Shqipërizë*, *firmëz*, *thelëz* “Poezi”; *shoqëz*, *gjurmëz* “Ritme të ...” *pikëz*, *flakëz*, *dhomëz*, *këngëz* “Eklipsi i ëndrrës” *motëz* “Më vjen keq për Jagon; *folezë* “Deti në mes” *shqerrkë* “Patat e egra”; *lulka* “Poezi”; *shegulkë* “Ritme të ...”

Më pak fjalë dalin me prapashtesën **-th**: *sqepth* “Më vjen keq për Jagon” *nxituarthi* “Dhjetori i shqetësuar”

Kontekstet e këtyre fjalëve janë dhënë për çdo fjalë te prapashtesat zvogëluese dhe përkëdhelëse.

### **Fjalë të formuara me përbërje**

Fjalët e përbëra janë të formuara nga bashkimi i dy temave, pjesët e tyre janë tema emërore, mbiemërore, foljore ose ndajfoljore. Formimet me përbërje janë me ngjyrim emocionues pozitiv apo negativ të theksuar, me tipare të stilit të lartë, e mbi bazën kryesisht të krahasimeve me sende e dukuri të botës rrethuese më të njohur. Të tilla janë: burra *zemërdielli*, nëpër bedenat e *dhëmbëdhëmballëve* të tij të rëna, në *këngëgjëmimin* e përjetshëm të gjakut, mbyl lotin *jetëvrrarë*, yjet *pullaflakëruese*, rini *ëndërrpavdekshme*, *shoqedhembshura* ime.

Interes paraqesin ndërtimet me emrin *gjysmë* si pjesë e parë e fjalëve të përbëra me kuptimet: 1. Gjysma e diçkaje. 2. *Përgjysmë*; në një farë mase, jo plotësisht, jo deri në fund; *gjysmanalfabete*, *gjysmëndrre*, *gjysmëmëshirë*, *gjysmëbrenge*, *gjysmëfati*, *gjysmëputhje*, *gjysmëfantazmat*, *gjysmëvdekur*, *gjysmëgjallë*.

**I.** Në një studim më të detajuar të këtyre fjalëve do të dallonim se **marrëdhëniet midis këtyre dy temave** janë të ndryshme. Dallojmë fjalë

të përbëra në të cilat njëra gjymtyrë përcakton tjetrën. Kemi kompozitat përcaktore dhe në disa fjalë të përbëra gjymtyrët janë të barasvlershme dhe përcaktojnë njësoj njëra tjetrën. Këto janë fjalë të përbëra të bashkërenditura.

Nga studimi i bërë kemi vërejtur se numri i kompozitave përcaktore është më i madh se ato të bashkërenditura.

Kompozita përcaktore: Gjymtyra e dytë përcakton të parën: *zemërdielli, jetëvrrarë, pullaflakëruese* etj. Gjymtyra e parë përcakton të dytën: *këngëgjëmimin - gjëmimin e këngëve*;

Kompozita këpujore: Me marrëdhënie bashkërenditëse dalin më pak fjalë: *dhëmbëdhëmballëve - dhëmbë e dhëmballë*

## II. Një tjetër grupim të fjalëve të përbëra mund të bëjmë edhe sipas vlerës leksiko- gramatikore:

Emërore: *kryekrushk, këngëgjëmimin, kryeatdheu, kryekuvend, Fatthëna.*

Mbiemërore: *zemërdielli, ëndërrpavdekshme, shoqedhëmbshur, fytyrdrobitur, durbuavitur, zorrëthatë, gjysmëvdekur, gjysmëmëshirë, jetëvrrarë.*

Ndajfoljore: *buzëmbremjes, gjysmëvdekur, ballëvrenjtur.*

## III. Fjalët e përbëra mund t'i grupojmë edhe nga ndërtimi, sipas vlerës leksiko-gramatikore të gjymtyrëve:

**Emër + emër:** *gjysmajalë, gjysmëzotat, shpirtinkulish, bojëshurrë, llapaqen, Bukëmira, Skuterrë, kulish-ujk, kulish-qen* “Nuk shitet shpirti ...”; *gjysmëfantazmat, gjysëmbrengë, gjysëmfiati, gjysëmmëshirë, gjysëmputhje, gjysëmëndërre, shpirti-shqiponjë, shpirtlepur, shpirt-maji, shkëmbguriçkë, këngëgjëmim* “Eklipsi i ëndrrës”; *kokëbrok, fundbisht, anëdet, mesrrugë* “Ku shkoni ju statuja”; *kryekuvend, pantallonaveqillota* “Dikush më buzëqeshte”; *surratpatate, gojëçorape, Grykëpishë, bythëtulja, buzëviç, mjekërakrep, gjysmënatë, gjysmëhapa, gjysmëterr, Kodërdet* “Deti në mes”; *kryezot, zemërdiell, Qafpëllumb* “Poezi”; *lulubeçkë* “Më vjen keq për Jagon”; *Fushëlugje* “Duke dalë prej ëndrrës”; *Krye-Engjëlli* “In-tenebris”

**Emër + mbiemër:** *gjysmëgjallë, ëndërrpavdekshme, fatvrrarë, pullaflakëruese, fatthëna* “Eklipsi i ëndrrës”; *shoqedhëmbshur, shpendugurzezë* “Poezi”; *këmbëçarë, dritëullirta, kryeçlironjës, monovdekje, plurivdje, mikrovdekje, makrovdekje* “Ku shkoni ju statuja”; *shtatlig, këmbëshkurtër, qimekuq, balukezi, Gurëbardhë* “Shokët”; *truplartë, krahëshkurtër, mendjeshkutër, gjysmëranore* “Deti në mes”; *ditëshkurtër* “Patat e egra”; *togëbardhë* “In-tenebris”; *Shqipërizezë* “Më vjen keq për Jagon”; *kockëlehtë, trupajthëm* “Duke dalë prej ëndrrës”; *gjysmëpulitur, gjysmëfjator* “Nuk shitet shpirti ...”

**Emër + ndajfolje:** *tejqiell, përtejferri, prapazë-rin, parazë-rin, paragojë-n, prapagjuhë-n, shalëplot* “Ku shkoni ju statuja”; *gjysmëhabitshëm* “Nuk shitet shpirti ...”;

**Ndajfolje + mbiemër prejpsor:** *porsastampuar, porsashtrydhur, porsazgjuar* “Deti në mes”; *porsagufuar* “Ritme të hekurta”.

Po i bëjmë këto grupime për fjalët e përbëra sepse duke e parë në disa kahe ndriçohet kuptimi i njësisë në tërësi.

Si neologjizma mund të trajtojmë edhe fjalët që janë në kërkim të njëfjalëzimit. *jetë-fëmijë/ lodrat-dhurata/ hidra-vdekje* “Drejt qindra shekujve ...”; *jetë-vdekja/ gozhdët-dhëmbë/ trokëllimat-ritme/ diell-e hije/ tokën-mëmë/ toka-njerkë/ dheut-gjak/ epokat-çarçaf/ thikëza-e-rreze drite/ bulëzat-lot/ ushtar-halldup/ rrezet-gishtrinj* “Poezi”; *kulish-qen/ kulish-ujk/ njerëzve-zota/ dritë-errësirë/ njeriu-zot/ njeriu-regji/ shpirt-kulish* “Nuk shitet shpirti ...”; *viktimë-jeta/ shpirt-njeri/ Skllëvër-bij-skllëvërish/ fatet-emrat/ jetë-vdekja/ shpirt-maji/ ëndrrat-kuaj/ perëndi-gomar/ hero-gomar/ njerith-perënduc* “Më vjen keq ...”; *shpirt-shqiponjë/ këngë-atdheu/ krahët-zgalem/ shekujt-skena/ larva-bakej/ koha-nënë/ ditë-Vajkal/ rreze-gishtrinj* “Duke dalë ...”; *dritë-far/ dritë-llampë/ dritë-siluetë/ dritë-rreze/ shpresë-fëmijë* “Vëlezër hamletë”; *qelizë-liria/ ndizet-shuhet/ natë-dashuri/ dheut-gjak/ hidra-vdekje/ epokat-çarçaf/ toka-mëmë/ toka-njerkë/ jetë-fëmijë/ bulëza-lot/ gozhdët-dhëmbë/ ombrellëza-qielli* “Poezi”; *shallin-qefin/ dallgë-dallgë/ dhemb-më-dhem/ fjala-fat/ krahët-zgalem/ sy-picigjatë/ fatet-emra/ jetë-vdekja/ lules-limoni* “Eklipsi i ëndrës”; *vejusha-dënesje/ qelizë-liria/ natë-dashuri/ zotave-njerëz/ mjerimi-vdekje* “In-tenebris”; *shtëpi-burg* “Dikush më buzëqeshte”; *fund-dheu* “Deti në mes”; *ushtar-halldup* “Ritme të hekurta”

Fjalët në kërkim të njëfjalëzimit nuk gjenden në një vepër të vetme, por në disa vepra. Duket se autori kërkon t’i bëjë ato pjesë e ligjërimit artistik.

Nga fjalët në kërkim të njëfjalëzimit bie në sy prirja për të ndërtuar fjalë të reja sipas gjedheve të gjuhës shqipe. Në *Fjalorin të gjuhës së sotme shqipe* (1980), gjenden fjalët e përbëra: *shpirtlepur* dhe *shpirtluan*. Sipas kësaj mënyre kompozimi krijohen nga autori kompozimet e reja: *shpirt-shqiponjë* dhe *shpirt-kulish*.

Në fjalor SHPIRTLEPUR *mb. mospërf*. Që është frikacak i madh si lepur, që trembet menjëherë dhe nga çdo gjë, zemërlepur. *Njeri shpirtlepur*.

SHPIRTLUAN, ~E *mb.* Që nuk ka frikë nga asgjë, që nuk i trembet syri; që çan gjithnjë përpara me guxim e trimëri, zemërluan. *Luftëtar shpirtluan*.

Autori ndërton dy fjalë të reja me kuptime të ndryshme: *shpirt-shqiponjë* i lirisë, me kuptim pozitiv, i vendosur për të shkuar përpara. Dhe *shpirt-kulish*, me kuptim negativ, i vogël, i pazoti, shkon pas të tjerëve: Kamarieri, një djalosh i njomë, me sy të kaltër e të gëzuar, buzagaz

përkëdheli me dorë *shpirtin-kulish*. - Nuk kisha parë *shpirt-kulish* kështu ngjyrë dlirtë...

Më poshtë po japin këto fjalë edhe në kontekst i cili jep më mirë efektet stilistikore të këtyre ndërtimeve:

Unë jam parë *sy-më-sy* me jetën, unë jam ngrënë *dhemb-më-dhemb* me vdekjen. shpresa *sy-picigjatë*, Në kokë *shallin-qefin*. Një gardh qerpikësh prej *lulesh-limoni*. Dhe *fjala-fat* e Dodonës, shpresë agimi të bardhë. Prap, shtrinte *krahët-zgalem* liria e pavdekshme dhe kënga... "Eklipsi i ëndrrës";

Ndihmë! këlthet *viktimë-jeta*.

shkel e thundron *shpirtin-njeri*.

*Skllëvër-bij-skllëvërish* shqyejnë ditë e natë,

me dhëmbë të ndohtë,

zemrën e Shpresës sime.

atje *fatet-emrat* tuaj, si milingona të dheut.

Ti je arena ku përleshet *jetë-vdekja*.

Zot, të isha bukurezë!

Të jetoja veç një natë,- veç një natë *shpirt-maji*...

*ëndrrat-kuaj*.

*Po të isha unë perëndi-gomar,*

*Po të isha unë hero-gomar.*

Vetëtimave - të pjellë kështu,

mëngjesi i dlirtë *njerithin-perënduc*. "Më vjen keq për Jagon"

*shpirti-shqiponjë* i lirisë ndezur për jetë të jetëve,

*kënga-atdheu* qiellor i pavdekësisë së poetëve,

shtrinte *krahët-zgalem* liria e pavdekshme dhe kënga,

*koha-nënë,*

*shekujt-skena,*

Evropa pillte *larva-bakej*. "Duke dalë prej ëndrrës"

*dritë-far* që sinjalizon,

*dritë-llampë* e ndezur,

*dritë-siluetë,*

*dritë-rreze* dashurie,

le t' u tregojmë *shpresave-fëmijë* rrugën për te njeriu. "Vëllezër hamletë"<sup>8</sup>

Dhe më e sinqertë është hipokrizia: *vejusha-dënesje*,

mbi vdekjen tënde tani hedh trëndafilin e fundit:

Lavdinë, që s'i duhet askujt...

S.O.S. *ndizet-shuhet*:

---

<sup>8</sup> F. Arapi, "Vëllezër Hamletë".

Shpëtoni... shpirtrat e hiçëve.  
*Natë-dashuri* e Shtutgardit!  
rreth kështjellës sate. "In-tenebris"

Nëpër brazda të tokës,  
ndjeva vlugun e *dheut-gjak* i bujshëm,  
të më shpërthejë nëpër shtat,  
Ne që trimërisë i buzëqeshëm,  
si dashurisë së parë,  
kur *hidra-vdekje*,  
me njëqind kokë mbi tokë ecte.  
Epokat s'janë lëvere që i lan në kazan.  
Pastaj në tel të historisë i nderke,  
për t'i tharë. *Epokat-çarçaf* ashtu mund të shpalosen,  
vetëm ndër shtyllat e mendimit budallë.  
Populli këtu mbi *tokën-mëmë* s'flirton me ideale,  
nëpër dhëmbë nuk përgjërohet poshtë e lart.  
*Toka-njerkë*. E huaj.  
I rëndonin yjet që i vareshin përsipër.  
Ashtu... ashtu... ashtu... Mos ki frikë... hop! *Jetë-fëmijë*... mbahu!  
U rrëzove?  
Shi. Qielli qan.

*Bulëzat-lot* bien me rrëmbim përmbi parvaz e thyhen stërkale. "Poezi"  
Më shkoi mëndja tek ato dhoma të mëdha e të gjera të asaj *shtëpie-burg*. "Dikush më buzëqeshte"; ti nuk je një *kulish-qen*, ti je *kulish-ujk*, të *njerëzve-zota*, ishte një lëmsh i asaj *dritë-errësire*, *njeriu-zot*, *Njeriu-regji*, Ai kulish i butë *pushatak*, Nuk kisha parë *shpirt-kulish* kështu ngjyrë të *dlirtë*..., "Nuk shitet shpirti në tetor"

Në korpusin leksikor të veprës së Arapit hasen formime tipike rreth 185 fjalë (që janë formuar nga autori) parashtesore e prapashtesore dhe sidomos me përbërje ku autori shfaq mjeshtëri dhe individualitet si në krijimet e hershme ashtu edhe në krijimet më të vona ku ngarkesa kuptimore është tepër e lartë.

Nga shembujt e mësipërm vihet re se formimet me parashtesë janë 23 fjalë të reja, me prapashtesë 72 dhe fjalë të formuara me përbërje rreth 90. Nëse në fjalët me përbërje do të shtonim edhe fjalët në kërkim të njëfjalëzimit rreth 140, numri i tyre do të jetë vërtet i lartë. Një pjesë konsiderohen jo vetëm si leksema të rralla, por mund të vlerësohen edhe si njësi gjuhësore stilistike. Dhe kjo, jo vetëm se janë të rralla, por edhe sepse me përmbajtjen e tyre a formën tingullore përcjellin ngjyresa të shumta dhe emocionalitet.

Meqenëse krijimtaria e autorit ka nisur qysh në vitet '60, pas *Fjalorit të gjuhës shqipe* (1954), me një numër të kufizuar fjalësh vetëm

25000 fjalë, me pak shpjegime dhe me pak thënie, themi se ka ndikuar, sipas mendimit tonë, edhe në pasurimin e **Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe** (1980), me fjalë e shprehje të reja. Nga ballafaqimi i një pjese të mirë të fjalorit të përdorur nga autori ynë, kemi vënë re se autori kërkon të theksojë dhe të nxjerrë në dritë një pjesë nga leksiku i veçantë i këtij fjalori (trajtuar edhe te fjalëformimi), kjo sepse janë fjalë të përdorura në vepra të shkruara në kohë të ndryshme, para dhe pas viteve '80 dhe për mendimin tonë, në mungesë të fjalorit të autorëve më në zë, mendojmë se kjo pjesë është edhe kontribut i autorit Fatos Arapit. Por objekt i këtij punimi janë fjalë të cilat nuk janë përfshirë ende në fjalorë. Këto janë fjalë të cilat gjenden në vepra të shkruara para viteve '80-të, por sidomos pas viteve '80-të dhe për më tepër në krijimet e fundit të autorit, si tek: "Eklipsi i ëndrrës", "In-tenebri", "Ku shkoni ju statuja" rreth viteve 1990 dhe "Nuk shitet shpirti në dhjetor" në vitin 2000.

Si përfundim mund të themi se gjuha në veprën e Fatos Arapit dëshmon, ndër të tjera, edhe për një pasuri leksikore të krijuar me mjete të larmishme fjalëformuese dhe sipas gjedheve të gjuhës shqipe.

#### **Vepra të shfrytëzuara të autorit**

*Poezi*. Tiranë, 1962.

*Shtigje poetike*. Tiranë, 1962.

*Ritme të hekurta*. Vjersha dhe poema. Naim Frashëri, 1968.

*Dhjetori i shqetësuar*. Naim Frashëri, Tiranë, 1970.

*Patat e egra*. Naim Frashëri, Tiranë, 1970.

*Dikush më buzëqeshte*. Tiranë, 1972.

*Drejt qindra shekujve shkojmë*. Poema dhe vjersha. Tiranë, 1977.

*Shokët*. Naim Frashëri, Tiranë, 1977.

*Poezi*. Naim Frashëri, Tiranë, 1983.

*Këngë të moçme shqiptare*. Studime. Tiranë, 1986.

*Deti në mes*. Naim Frashëri, Tiranë, 1986.

*Duke dalë prej ëndrrës*. poezi. Naim Frashëri, Tiranë, 1989.

*Ku shkoni ju, statuja*. poezi. Naim Frashëri, Tiranë, 1990.

*Më vjen keq për Jagon*, poezi. Albin, 1994.

*In-tenebri*. Poezi. Marin Barleti, Tiranë, 1996.

*Kujtohem që jam*. LVC. Tiranë, 1997.

*Gloria victis*. Poezi. Neraida, Tiranë, 1997.

*Vëllezër Hamletë*. Poezi. Toena, Tiranë, 2001.

*Eklipsi i ëndrrës*. Poezi. Tiranë, 2002.

*Nuk shitet shpirti në tetor*. Toena, Tiranë, 2002.

**BIBLIOGRAFI**

- Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*. Tiranë, 2008.
- Dhrimo, A., *Formimi i mbiemrave në gjuhën shqip*. “Studime filologjike”, 1972, 3.
- Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë, 2002.
- Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- Islamaj, Sh., *Gjergj Fishta, Gjuha dhe stili. II*. Prishtinë, 2012, f. 390.
- Kostallari, A., *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon...”, 1, Tiranë, 1972.
- Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*. Tiranë, 1972.
- Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972.
- Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*. Tiranë, 1989.
- Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Ribotim, Tiranë, 2005.
- Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Ribotim, Tiranë, 2005.
- Xhuvani, A., Çabej, E., *Parashtesat e gjuhës shqipe*. BSHSH, 3, 1956.
- Xhuvani, A., Çabej, E., *Prapashtesat e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1962.